



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 465 Prot.

Tiranë, më 03.04 2018

VENDIM Nr. 85, datë 20.03.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4, datë 20.03.2018, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Kërkime të përbashkëta në ishullin e Maligradit të Prespës së Madhe, Shqipëri (2018-2020)"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike) me drejtues Prof.Dr. Adem Bunguri (IA) dhe Prof. Dr. S. Ikonomidhis (IMNK, Athinë), paraqitur nga Instituti Arkeologjisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Kërkime të përbashkëta në ishullin e Maligradit të Prespës së Madhe, Shqipëri (2018-2020)"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike) me drejtues Prof.Dr. Adem Bunguri (IA) dhe Prof. Dr. S. Ikonomidhis (IMNK, Athinë), paraqitur nga Instituti Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:

a) Survey në anën veriore dhe lindore të ishullit bazuar në vrojtimin fotolinear dhe fotografimin ajror të ishullit me dron.

b) Gërmime në dy sektorë:

- Sektori I në pjesën veriore të ishullit, me qëllim zbulimin e depozitimeve kulturore prehistorike, gjasisht të Neolitit të Mesëm dhe të epokës së Bronzit. Puna në këtë sektor nga pala shqiptare do të drejtohet nga A. Bunguri dhe P. Lera;
- Sektori II në pjesën jugore të ishullit ku do të kryhen rlevime në Kishën e Shën Mërisë (A 40.791706 20.934009(Google maps), sipas kartelës së trashëgimisë së paluajtshme. Do të kryhen punime për sistemin e lehtë të terrenit në pjesën e jashtme të kishës. Puna në këtë sektor nga pala shqiptare do të drejtohet nga Dr. Elio Hobdari.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2018.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sil/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO



Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al